



2022

**Raporti
Vjetor**

Përmbajtja

- 3** **Kush jemi ne!**
- 4** **Fjala e Drejtorit Gjeneral**
- 6** **Përkujdesi shëndetësor dhe përmirësimi i
qasjes në shërbimet shëndetësore.**
- 12** **Përmirësimi i pozitës sociale të njerëzve në
nevojë dhe zhvillimi i komunitetit për përfshirje
dhe kohezion social**
- 22** **Krijimi i parakushteve për rritjen e
punësueshmërisë dhe të vetëpunësimit**
- 28** **Realizimi i së drejtës në edukim
dhe arsim cilësor**
- 37** **Ndihma në situatat e fatkeqësive
natyrore dhe të konflikteve**
- 44** **Buxheti Vjetor**

Kush jemi ne!

Caritas Kosova është institucion i Kishës Katolike në Kosovë misioni i së cilës është promovimi i paqes, solidaritetit, dhe dashurisë në mes të njerëzve. Caritas Kosova është anëtare e Caritas Internationalis (CI) dhe Caritas Europa (CE) që shërben dhe ofron ndihmë për më të varfërit pa dallim gjinie, race, kombësie, religjioni, etj

Aktiviteti i Caritas Kosova në vitin 2022, në përputhje me strategjinë, ishte zbatimi i programeve dhe projekteve në kuadër të pesë fushave strategjike:

- Përkujdesi shëndetësor dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore;
- Përmirësimi i pozitës sociale të njerëzve në nevojë dhe zhvillimi i komunitetit për përfshirje dhe kohezion social;
- Krijimi i parakushteve për rritjen e punësueshmërisë dhe të vetëpunësimit;
- Realizimi i së drejtës në edukim dhe arsim cilësor;
- Ndihma në situatat e fatkeqësive natyrore dhe të konflikteve.

Nëpërmjet veprimeve të shumta, jemi përpjekur të jemi në afërsi të atyre që janë në nevojë për të lehtësuar problemet në të cilat ata jetojnë, siç janë varfëria dhe izolimi.

Udhëheqja jonë

President i Caritas Kosova është Mons. Dodë Gjergji - Ipeshkëv i Kosovës, ndërsa Drejtor Gjeneral është Don Viktor Sopi.

Të nderuar partnerë dhe miq të Caritas Kosova, në këtë raport vjetor gjeni informacion mbi aktivitetet e zbatuara në mbështetje të personave në nevojë gjatë vitit 2022.

Të dashur bashkëpunëtor të Caritas Kosova



Caritas Kosova si institucion bamirësie në Kosovë vazhdon të luaj rolin e vet kyç në përkrahjen e personave në nevojë. Këtë e bëjmë duke analizuar me kujdes gjendjen sociale dhe ekonomike të qytetarëve dhe duke u munduar të shfrytëzojmë çdo mundësi që na jepet për të qenë në shërbim të tyre.

Vendi ynë vazhdon të përballlet me shumë sfida të cilat kanë ndikim në vetë ekzistencën e shumëkujt, sfida që rrezikojnë dhe dobësojnë ecjen e njeriut drejt qëllimit primarë, për të pasur një jetë të mirë, në paqe dhe në bashkëpunim me njëri tjetrin. Për këtë arsye Caritasi përpiqet që të ndikoj drejtpërsëdrejti në mbrojtjen dhe promovimin e dinjitetit njerëzor i cili është i pacënuar dhe paraqet epiqendrën e veprimit tonë duke u konkretizuar në promovimin e drejtësisë sociale dhe fuqizimin e të nëpërkëmburve që të realizojnë të drejtat e tyre themelore në të gjitha fushat e zhvillimit njerëzor.

Edhe gjatë vitit 2022 Caritas Kosova ka vazhduar me përkushtim të madh zbatimin e projekteve të ndryshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës, i përkrahur nga Partner kombëtar dhe ndërkombëtar me të cilët kemi bashkërenduar aktivitetet për t'ju përgjigjur sa më mirë nevojave të cilat i hasim në teren gjatë punës sonë të përditshme. Në vazhdimësi jemi të përkushtuar që të zbatojmë masat e duhura për të fuqizuar komponentën sociale në vend, duke ofruar përvojën, profesionalizmin dhe vullnetin tonë të mirë në ofrimin e shërbimeve për kategoritë e caktuara si dhe ofrimin e përkrahjes për të siguruar përfshirje sociale, zhvillim të qëndrueshëm dhe edukim adekuat.

Po ashtu, edhe gjatë këtij viti, Caritasi i ka kushtuar vëmendje të posaqme zhvillimit organizativ dhe avansimit profesional si një aspekt i rëndësishëm i veprimit tonë që siguron qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të shërbimit.

Një falenderim të përzemërt shprehim për të gjithë ata që angazhohen në Caritas Kosova që njeriut në nevojë i kthejnë buzëqeshjen, e përkrahin, e bëjnë të ndjehet i rëndësishëm, i fuqizuar dhe i trajtuar me dinjitet.

Zoti ju bekoftë!

Don Viktor Sopi – Drejtor Gjeneral

Fusha strategjike:

Përkujdesi shëndetësor dhe
përmirësimi i qasjes në shërbimet
shëndetësore.



Home Care/Përkujdesi Shtëpiak



Home Care apo projekti i Përkujdesit Shtëpiak që ka dy komponente kryesore, shërbimet shëndetësore dhe ato sociale për të moshuarit e vetmuar dhe për personat me regjim shtrati, është një projekt i veçantë i Caritas Kosova në kuadër të sektorit të Përkujdesit, i cili zbatohet në bashkëpunim dhe bashkërendim të veçantë me institucionet e Republikës së Kosovës.

Ky projekt është i hartuar dhe zbatohet në atë mënyrë që t'u përgjigjet nevojave të grupeve të marginalizuara në Kosovë.

Gjatë vitit 2022, duke parë nga afër situatën e rënduar sociale, shëndetësore dhe ekonomike të përsoneve të sëmurë dhe të moshuar dhe pas identifikimit dhe vlerësimit të nevojave të çdo individi, kemi ofruar shërbimet sociale dhe shëndetësore në shtëpitë e përfituesve me një bashkëpunim dhe koordinim edhe me institucionet tjera sociale dhe shëndetësore në nivel vendi.





Ofrimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore, sipas konceptit Home Care, ka pasur për qëllim që t'iu përgjigjet nevojave më elementare sociale, shëndetësore dhe psikologjike që kishin të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara gjatë vitit 2022. Shumë nga të moshuarit, përfitues të projektit, vazhdojnë të jenë të vetmura dhe të braktisur nga familjarët e tyre dhe nga shoqëria, dhe fatëkeqesisht nuk kanë mbështetje të mjaftueshme për të realizuar jetë dinjitoze.

Projekti Home Care ka ndikuar që jeta, mirëqenia dhe shëndeti i personave të moshuar dhe të vetmuar të përmirësohet si rezultat i ofrimit të kujdesit social dhe shëndetësorë gjatë gjithë vitit.

Në mënyrë të vazhdueshme Home Care ka pasur ndikim pozitiv edhe në punësimin e stafit profesional, të cilët janë të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ku përmes angazhimit në projekt kanë krijuar përvojat e tyre të para në punë.

Asistenca me pako ushqimore dhe materiale higjienike për të moshuarit e vetmuar dhe të sëmurë, ka qenë e vazhdueshme. Po ashtu, Caritas Kosova vazhdimisht ka shërndarë informacionet nga tereni duke ngritur edhe më lart bashkëpunimin me të gjithë akterët relevant.

1540 persona të moshuar dhe të sëmurë si dhe 98 persona me aftësi të kufizuar, kanë pranuar 64850 shërbime shëndetësore dhe sociale në shtëpi, sipas konceptit të Home Care, gjatë vitit 2022. Po ashtu, 211 persona janë përkrahur me shtretër, karroca, shetitore, ulëse tualeti, etj.

Partnerët: Ministria e Punës, Financave dhe Transfereve, Komunat: Prizren, Ferizaj, Viti, Suharekë, Fushë Kosovë, Istog, Shtime, Gjakovë, Malishevë

Mbështetja e shërbimeve Ambulantore



Përmes këtij angazhimi, respektivisht ofrimit të shërbimeve ambulantore, Caritas Kosova synon jo vetëm funksionalizimin e punkteve shëndetësore në lokacionet ku mungon shërbimi i tillë, por edhe ofrimin e shërbimeve për popullësinë apo shtresën më të varfër e cila ka qasje të kufizuar ose asnjëfare në shërbimet ambulantore. Kjo gjithashtu rrit edhe mobilitetin e vet përfituesve, duke rikthyer besimin në vlerat njerëzore të solidaritetit.

Si rezultat i nevojave të mëdha për shërbime shëndetësore dhe sociale në vend, Caritas Kosova ka vazhduar me intenzitet të lartë ofrimin e tyre si dhe ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të gjitha aktivitetet shëndetësore dhe sociale të bëhen në koordinim me institucionet publike si: Ministrinë e Shëndetësisë, Drejtoritë e Shëndetësisë në Komunitat respektive, QKMF-të, Ambulantat, etj.

Në kuadër të këtij angazhimi, Caritas Kosova ka mobilizuar tërë stafin shëndetësorë në 9 Komunitat respektive ku ka ofruar shërbime shëndetësore dhe sociale duke u munduar që të kontribuoj në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Gjatë vitit 2022, në kuadër të shërbimeve ambulantore, kemi ofruar mbi 1.10 milion shërbime shëndetësore dhe sociale për 409234 përfitues.

Partnerët: Komunitat - Prizren, Ferizaj, Gjilan, Viti, Fushë Kosovë, Shtime, Suharekë, Istog, Malishevë

C.I.K. Ambulanca Specialistike e Mjekësisë Familjare & Ambulanca e Stomatologjisë



Në kuadër të përkujdesit shëndetësor, Caritas Kosova ka edhe ambulancën specialistike të mjekësisë familjare dhe ambulancën e stomatologjisë, në Dubravë të Ferizajt. Kjo ambulancë funksionon në hapësirat e Qendrës Sociale Edukative 'Caritas Kosova' dhe ofron shërbime shëndetësore pa pagesë për banorët e fashatit Dubravë. Ambulanca është e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, ka staf profesional mjekësor si dhe pajisjet e nevojshme medicinale, dhe prezenca e saj në këtë lokalitet është e një rëndësie të veçantë marrë parasysh nevojën e komunitetit si dhe rëndësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore sa më pranë tyre. Aktualisht Ambulanca funksionon me orarë të plotë dhe përveç shërbimeve shëndetësore luan një rol shumë të rëndësishëm në shpërndarjen e informacioneve dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e kujdesit për shëndetin për fëmijët që frekuentojnë Qendrën mbi rëndësinë e parandalimit dhe trajtimit shëndetësor.

Në kuadër të Ambulancës Specialistike, gjatë vitit 2022, kemi ofruar 5815 shërbime shëndetësore dhe stomatologjike pa pagesë gjatë 3425 vizitave për banorët e Dubravës.

Po ashtu, në kuadër të Home Care, kemi ofruar mbi 5000 shërbime sociale dhe shëndetësore për mbi 90 persona të moshuar dhe të sëmurë.

Fusha strategjike:

Përmirësimi i pozitës sociale të
njerëzve në nevojë dhe zhvillimi i
komunitetit për përfshirje dhe
kohezion social





Bamirësia dhe Solidariteti

Që nga fillet e para të angazhimit të Caritas Kosova, asistencë sociale për familjet që jetojnë në varfëri ekstreme ka qenë një nga objektivat kryesore.

Gjatë vitit 2022 janë ndihmuar shumë familje me ndihma në ushqim, veshmbathje, mobilje, etj. Po ashtu, një ndihmë e madhe ju ka dhënë edhe shoqatave të ndryshme të cilat përfaqësojnë: familjet e varfra, të moshuarit, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, etj. Në vitin 2022 janë shpërndarë 61.02 ton me ndihma humanitare.

Ky projekt paraqet një angazhim të vazhdueshëm të Caritas Kosova dhe është i mundur falë bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm, sidomos me organizatën vullnetare Junge Leute Helfen nga Gjermania dhe organizatën Malteser, po ashtu nga Gjermania, të cilët na mbështesin me ndihma humanitare.

Partnerët: Junge Leute Helfen, Malteser, Bamirësit





SOCIETIES

Projekti SOCIETIES, faza 2, ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve, përgjegjësinë dhe efektivitetin e OShC-ve në menaxhimin e iniciativave të përfshirjes sociale dhe de-institucionalizimit si dhe në promovimin dhe avokimin për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me standardet e pranimit në Bashkimin Evropian.

Gjatë vitit 2022 projekti zhvilloi aktivitete lidhur me skemën e nën-granteve dhe monitorimin e tyre, programin e ngritjes së kapaciteteve për OSHC-të. Po ashtu, gjatë këtij viti, u organizuan 3 trajnime, një konferencë regjionale në Beograd-Serbi si dhe një vizitë studimore në Shqipëri.





Programi 3 ditor i vizitës studimore në Shqipëri ishte fokusuar në qytetin e Shkodrës dhe Tiranës, në njohjen e situatës së bashkëpunimit dhe rrjetëzimit të OSHC-ve dhe personave me aftësi të kufizuara si dhe bashkëpunimi i tyre në nivel institucionesh në Shqipëri. Pjesëmarrës nga Kosova ishin organizatat: Handikos, Duart Plot Mëshirë si dhe organizata partnere në projekt Qendra për Jetesë të Pavarur. Gjatë vizitës pjesëmarrësit tanë patën mundësi të shohin projektet e ndryshme inovative sociale për personat me aftësi të kufizuara të drejtuara nga OJQ-të në Shqipëri dhe shërbimet dhe politikat e drejtuara nga autoritetet lokale dhe kombëtare.

Janë mbajtur takimet e rregullta të grupit menaxhues, për përgatitjen e temave të trajnimeve, vizitës studimore, konferencës si dhe aktiviteteve tjera.

Partnerët: Bashkimi Evropian





Ndalo dhe Ndihamo

Përmes projektit STOP AND HELP/NDALO DHE NDIHMO, Caritas Kosova angazhohet për përmirësimin e parandalimit të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore, për të avancuar protokollet dhe mjetet e ndërhyrjes dhe për të ngritur në një nivel më të lartë sistemin e shërbimeve të referimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje. Në këtë mënyrë projekti mbështet betejën e vazhdueshme kundër këtyre akteve kriminale të dhunshme që po ndodhin gjithnjë e më shumë. Ky veprim, i mundëson Caritas Kosova si organizatë zbatuese, të arrijë ndikim pozitiv në numrin më të madh të mundshëm të anëtarëve të grupeve të synuara, duke marrë parasysh rëndësinë e ndikimit shkatërrues të problemit në fjalë. Projekti zbatohet në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Mitrovicë Jugore.

Veprimet dhe shërbimet e projektit, gjatë vitit 2022, iu dedikuan betejës kundër këtyre akteve kriminale të dhunshme që po ndodhin gjithnjë e më shumë, veçanërisht gjatë problemeve globale shëndetësore. Seancat informative, kampanja e organizuar me kujdes, materialet sensitive promovuese të të drejtave të viktimave, ofrimi i materialit bazë të drejtpërdrejtë dhe ndihma mjekësore, sjellin një ndjenjë shprese dhe lehtësimi për viktimat dhe të gjithë anëtarët e familjes.



Gjatë vitit 2022 është ofruar mbështetje e drejtpërdrejtë ekonomike për viktimat e dhunës përmes edukimit (trajnime dhe punëtori) si dhe përmes shërbimeve psikosociale dhe të ndihmës juridike falas. Po ashtu, janë ndarë pajisje/grante kolektive për institucionet relevante. Mbi 450 persona janë përfshirë në projekt në mënyra të ndryshme.

Partnerët: Bashkimi Evropian, Save the Children International në Kosovë





Kuzhina popullore

Caritas Kosova, bazuar në misionin e vet dhe opsionin preferencial për të varfrit, përmes kuzhinës popullore, ofron shujta ushqimore ditore për personat e vetmuar dhe në nevojë. Prishtina si kryeqendër urbane me popullsi të madhe, rrjedhimisht ka edhe shumë persona që përballen me vështirësi ekonomike dhe sociale. Sidomos të moshuarit dhe personat tjerë të vetmuar, vazhdojnë të jenë një nga grupacionet më në nevojë dhe të cënuar në çështjen e sigurimit të ushqimit.

Përmes këtij projekti dhe mbështetjes nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Caritas Kosova ka qenë në gjendje që përmes funksionalizimit të kuzhinës popullore të ju përgjigjet kërkesave të shumta për shujta ditore të atyre që në periudhë pandemie e kanë edhe më të vështirë sigurimin e ushqimit.

Gjatë vitit 2022, Caritas Kosova ka ofruar 23707 shujta të ngrohta ushqimore për më shumë se 120 persona. Përveç shujtave të ofruara në kuzhinën popullore, janë ofruar edhe shujta të ngrohta në shtëpitë e të moshuarve, sidomos për ata me regjim shtrati për shkak të sëmundjeve. Po ashtu, në kuadër të këtij projekti janë shpërndar edhe 90 pako ushqimore për familjet e varfra.

Partnerë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve



Pakot humanitare, Masa 3.4



Ky projekt i Caritas Kosova është fokusuar në shpërndarjen e pakove ushqimore për kategoritë e cënueshme në komunat: Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë, si vazhdimësi e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në përkrahje të të varfëve.

Gjatë vitit 2022, në zona të thella rurale, por në shumë raste edhe në qendra urbane, aty ku jetojnë shumë familje të varfra, në vështirësi socio-ekonomike, dhe me mundësi shumë të vogla për sigurimin e ushqimit Caritas Kosova ka shpërndarë 2000 pako me produkte ushqimore (950 në Gjilan, 950 në Mitrovicë dhe 100 në Ferizaj).

Kjo kategori e njerëzve paraqet një nga grupet kryesore të synuara të Caritas Kosova, sepse shtylla e veprimit tonë është: **opsioni preferencial për dhe me të varfrit**.

Përmes këtij projekti, në bashkëpunim me Qendrat për Punë Sociale në komunat respektive, si dhe përkrahjes nga MFPT, Caritas Kosova ishte në gjendje që të mbështes përfituesit direkt dhe të ju lehtësoj atyre sigurimin e ushqimit, si një nga nevojat elementare për jetë.

Partnerë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve





ACTIVE

Projekti ACTIVE - Komunikimi i aksesueshëm drejt përfshirjes së personave të cenueshëm dhe të përjashtuar në Ballkanin Perëndimor, qëllim kryesor ka krijimin e materialeve në gjuhën e lehtë të lexueshme duke zhvilluar konceptin e komunikimit gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për njerëzit e disavantazhuar. Personat që përfitojnë nga ky projekt janë: personat me aftësi të kufizuar, vështirësi në të mësuar, personat me sëmundje mendore, personat me mungesë të edukimit, grupe minoritare, persona të moshuar, migrantë, etj.

Kuptimi i komunikimit të aksesueshëm është shumë i rëndësishëm dhe ka të bëjë me përgjigjen ndaj faktit që njerëzit kanë nevoja të ndryshme komunikimi, dhe kështu duke zhvilluar produkte dhe materiale në përputhje me rrethanat të mundohemi që t'ju sigurojmë sa më shumë akses adekuat njerëzve në nevojë. Ky projekt rajonal, përveç në Kosovë, zbatohet edhe në: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mali të Zi dhe Serbi.





Në vitin 2022 janë mbajtur 3 Module të trajnimeve për stafin në kuadër të projektit. Po ashtu, stafi i projektit ka përkthyer përshkrimin e projektit ACTIVE në gjuhën shqipe duke ndjekur standartet e 'lehtë për ta lexuar' (Easy-to-Read). Janë zhvilluar vizita në institucione publike dhe organizata në mënyrë që të bëhet prezantimi i projektit. Gjatë takimeve janë plotësuar disa pyetësor rreth temave për krijim e Broshurave informuese.



Fusha strategjike:

Krijimi i parakushteve për rritjen
e punësueshmërisë dhe të
vetëpunësimit



ELBA dhe Employ Yourself



ELBA (Emergency Labour in Balkans) dhe Employ Yourself janë iniciativa të projektuara për t'iu përgjigjur krizës ekonomike në Evropën Juglindore dhe pjesë të këtij projekti janë: Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Greqia, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia Veriore. Ekonomia sociale njihet si një mënyrë për të angazhuar dhe për të fuqizuar të gjithë shoqërinë, sektorin publik si dhe sektorin privat, nga organizata fitimprurëse tek organizatat jo-fitimprurëse, nga territoret tek komunitetet, për të zhvilluar një model të ri ekonomik që përfshin njerëzit në nevojë si burim aktiv i shoqërisë.

Ajo që i bën ata pjesë të ekonomisë sociale janë vlerat dhe veçoritë e përbashkëta që i bashkojnë, për shembull ata vendosin njerëzit mbi fitimet, qeverisen në mënyrë demokratike dhe ri-investojnë shumicën e fitimeve.

Gjatë vitit 2022, Caritas Kosova me projektin ELBA dhe Employ Yourself ka ndarë skemën e subgranteve (për bizneset fillestare dhe ndërmarrjet sociale ekzistuese).

Po ashtu, gjatë vitit 2022, ky projekt ka organizuar trajnime të ndryshme për ndërmarrje të ndryshme, OJQ dhe qendrat rinore me temat:

- Trajnim për perspektivat e ekonomisë sociale në veprimet kundër varfërisë
- Vetë-ndërmarrësia e të rinjve
- "Mendo biznes"
- dhe disa trajnime të tjera online

Partnerët: Caritas Italiana, Secours Catholique – Caritas France, Catholic Relief Services, Caritas Spain, Bashkimi Evropian – Erasmus+



YourJob

Projekti YourJob i Caritas Kosova është projekt që ka për qëllim përgatitjen e të rinjve për tregun e punës. YourJob është duke u zbatuar në komunat: Prizren, Gjakovë, Viti, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut dhe Kllokot. Përveç në Kosovë, YourJob zbatohet edhe në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi. Objektivi kryesor i projektit YourJob konsiston në mbështetjen e të rinjve nga mosha 15 vjeçare deri në moshën 30 vjeçare, në përgatitjen e tyre për një punësim sa më të qëndrueshëm.

Komponentet e projektit përfshijnë: këshillim profesional, trajnime në Soft Skills, trajnime të tjera profesionale, punë praktike, dhe grante, përmes të cilave të rinjtë realizojnë idete e tyre në ndërmarrësi.

Viti 2022, është viti i fundit nga faza e parë e implementimit të projektit i cili rezultoi të jetë shumë i suksesshëm duke arritur të mbështesë të rinj në fusha të ndryshme dhe duke iu ofruar përgatitje profesionale për tregun e punës.

Gjatë këtij viti, projekti YourJob ka përkrahur 872 të rinj, ku nga ta në mënyrë direkte janë përkrahur 101 të rinj në punë praktike, rreth 165 të rinj kanë kryer trajnime profesionale, rreth 109 të rinj janë trajnuar në soft skills dhe janë ndarë 12 grante. Nga këta përfitues 58% kanë qenë femra.

Përmes projektit YourJob, Caritas Kosova ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani-biznese si: Bit Academy, United Pixels, Koshi Group e shumë kompani të tjera në qytetet ku zbatohet projekti.

Këtë vitit u realizua vizita studimore në Austri, ku stafi i projektit zhvilloi vizita tek projektet e ndryshme të Caritas Austria dhe bashkëpunëtorët. Gjatë kësaj vizite u punua në mënyrë intensive në planifikimin dhe përgatitjen e fazës së dytë.



Në mënyrë të vazhdueshme përfituesit e projektit janë vizituar nga Donatorët dhe Partnerët, gazetarë nga Franca si dhe akter të ndryshëm të përfshirë në projekt.

Ngjarje shumë e rëndësishme në vitin 2022 ishte Konferenca përmbyllëse e projektit YourJob (Prill 2019-Prill 2022), ku u prezantua raporti i punës tre vjeçare të realizuar në Kosovë. Këtu morrën pjesë përfaqësues të lartë nga Caritas Kosova, Agjencioni Austriak Për Zhvillim, Caritas Austria, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, Agjencia e Punësimit, Nënkrjetarë dhe Drejtorë të Komunave ku u realizua projekti, si dhe përfaqësues nga niveli akademik. Në tryezë diskutimit ishin të pranishëm edhe bashkëpunëtor nga bizneset, nga Caritas-et e vendeve fqinje si dhe përfitues të projektit. Kjo tryezë ishte mundësi diskutimi me të pranishmit edhe për fazën e re të projektit që filloi më 1 nëntor 2022.

Të rinjtë përfitues të projektit janë gjithmonë falënderues dhe vlerësojnë lartë përkushtimin e stafit dhe punën në shërbim të tyre për t'u fuqizuar dhe mundësuar atyre çasje në tregun e punës.

Partnerët: Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), RENOVABIS, Caritas Austria, Secours Catholique – Caritas France





PRAXIS

Projekti PRAXIS është i definuar si një proces i cili bënë të mundur përdorimin e njohurive teorike në praktikë. Përkundër njohurive teorike të të rinjve, ende kemi një boshllëk të madh në mes tyre dhe tregut të punës, prandaj fokusimi i PRAXIS në dimensionin praktik është përgjigje për nivelin e lartë të papunësisë së vajzave dhe djemve të rinj në Kosovë dhe Mal të Zi.

Ky projekt i'u dedikohet të rinjve dhe do t'ju siguroj atyre informacionet e duhura për vendimmarrje më të mirë për orientimin profesional. Praktika dhe Edukimi janë mbështetja konkrete e këtij projekti që ju mundëson të rinjve të jenë me konkurent në tregun e punës.

Gjatë vitit 2022 është punuar vazhdimisht në zbatimin e rezultateve të pritura në lidhje me kualifikimin e mëtejshëm të këshilltarëve të karrierës, konceptimin dhe publikimin e broshurave të orientimit të karrierës, sesioneve kolektive dhe individuale të orientimit në karrierë, konsultime të mëtejshme, konceptimin e kurrikulave të trajnimit të aftësive të buta, rekrutimin e trajnerëve, trajnimet e këshilltarëve dhe identifikimin e kompanive/organizatave pritëse për internshipe dhe krijimi i bazës së të dhënave.

Konkretisht, pjesëmarrjen aktive, krahas partnerëve, e kanë ofruar të gjithë akterët relevantë të përfshirë në zonën ndërkufitare (Kosovë dhe Mal të Zi). Në vitin 2022, gjatë zbatimit të projektit, nga veprimet e parashikuara kanë përfituar 1441 përfitues direkt dhe më shumë se 1060 përfitues indirekt.



Në përgjithësi, grupet e synuara kanë treguar interes të madh për të marrë pjesë në aktivitetet e projektit, duke i vlerësuar lart mundësitë për zhvillimin e tyre për tregun e punës. Sipas përfituesve PRAXIS ka ofruar shumë mundësi për të rinjt dhe kanë vlerësuar në mënyrë të veçantë orientimin në karrierë, trajnimet e aftësive të buta, internshipin si dhe vullnetarizmin dhe mentorimin.

Fusha strategjike:

Realizimi i së drejtës në edukim
dhe arsim cilësor



Kopshti Engjujt



Në kuadër të programeve dhe projekteve të veçanta që zbaton Caritas Kosova, edukimi parafillor dhe menaxhimi i kopshteve për fëmijë paraqet objektivë të rëndësishme, prandaj edhe gjatë vitit 2022 Caritas Kosova ka menaxhuar me sukses kopshtin e fëmijëve "Engjujt" me qëllim të ofrimit të shërbimeve kualitative edukuese të kujdesit ditor për fëmijët të cilët kanë nevojë që edukimi dhe socializimi i tyre të bëhet me një standard të lartë të edukimit dhe profesionalizmit.

Misioni i kopshtit është krijimi i një vendi të sigurt, të përshtatshëm, të ngrohtë dhe të planifikuar mirë, për fëmijët e moshës 0.9-6 vjeç, në përputhje me veçoritë individuale të secilit fëmijë.

Kopshti Engjujt, gjatë vitit 2022, ka ofruar shërbimet e kujdesit për gjithsej 250 fëmijë, me një mesatare ditore prej rreth 210 fëmijë. Kopshti Engjujt është i licencuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ka lokacion shumë të përshtatshëm, hapësira gjelbëruese dhe objekt të modeluar posaçërisht për botën e këndshme të fëmijëve. Ne krijojmë avantazh në realizimin e planprogramit përmes aktiviteteve të cilat kërkojnë hapsirë adekuate, duke përfshirë këtu edhe hapsirat për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Partner: Komuna e Ferizajt



My Right – Qendra e Edukimit të Hershëm



Projekti My Right/E Drejta Ime ka në fokus fëmijët me aftësi të kufizuar, prindërit e tyre si dhe institucionet arsimore lokale. Ky projekt ka dy komponente kryesore në vetvete:

- Edukimin e Hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuar/Qendra e Edukimit të hershem për fëmijët 0-5 vjeç
- Gjithpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin e rregullt shkollor





Gjithsej 84 fëmijë janë mbështetur gjatë vitit 2022 në Qendrën e Edukimit të Hershëm si dhe në institucionet shkollore. 41 fëmijë të moshës 0 deri në 6 vjeç mbështeten sistematikisht në baza ditore në Qendër. Orari i caktuar për çdo fëmijë shërben si plan pune. Bazuar në nevojat e fëmijëve, oraret dhe planet e tyre janë përshtatur, që do të thotë se një fëmijë mund të marrë më shumë shërbime.

Brenda ditës afërsisht 10 fëmijë mund të marrin shërbime në Qendër, ndërsa brenda javës të gjithë 41 fëmijët përfshihen në shërbime. Pjesëmarrja e fëmijëve evidentohet përmes raportit javor të përgatitur nga stafi i Qendrës. Formularët e raportit plotësohen nga stafi në baza javore dhe përmbajnë shërbimet e ofruara. Gjithashtu, 22 fëmijë të regjistruar në Qendër janë të pajisura me një plan individual tranzicioni, i cili shërben si ndjekje sistematike e zhvillimit të fëmijës gjatë një periudhe të caktuar.

Partnerët: Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Caritas Austria, Komuna e Prizrenit



Përfshirja Sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian



Caritas Kosova punon intenzivisht në zhvillimin e projekteve për të përkrahur përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë kosovare, me theks të veçantë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike të këtyre komuniteteve. Duke u bazuar në gjendjen e rëndë socio-ekonomike, arsimore dhe kulturore të këtyre komuniteteve, Caritas Kosova ka fokusuar aktivitetet e saja në katër komponentë kryesorë, në Edukim, Kulturë, Shëndetësi dhe Asistencë Sociale. Përkundër intervenimit në shumë fusha këto komunitete vazhdojnë të përballen me probleme të mëdha, sidomos me papunësinë, mos përfshirjen, segregimin, infrastrukturën e pakët, etj.



Qendra Sociale-Edukative "Caritas Kosova" – Dubravë, Ferizaj



Në Qendrën Sociale dhe Edukative 'Caritas Kosova' në Dubravë të komunës së Ferizajt, gjatë vitit 2022 janë ofruar 33920 shërbime edukative, shëndetësore dhe sociale për komunitetet që jetojnë aty. Në komponentën e edukimit Qendra numroi 262 nxënës (147 femra dhe 115 mashkuj) në të gjitha nivelet.

Përveç shërbimeve edukuese, në Qendër janë ofruar edhe shërbime sociale. Punëtorja Sociale ka punuar në mënyrë individuale me 6 fëmijë të grupmoshave dhe gjinive të ndryshme.





Me aktivitete të veçanta janë shënuar Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve si dhe festa të ndryshme në kuadër të të cilave synohet rrjetëzim dhe bashkëpunim i fëmijeve nga komunitete të ndryshme.

Në kuadër të Qendrës është edhe C.I.K. Ambulanca Specialistike e Mjekësisë Familjare & Ambulanca e Stomatologjisë e cila ofron shërbime shëndetësore për qytetarët e Dubravës.

Në Qendër është ofruar edhe asistencë sociale për banorët e Dubravës të cilët janë përkrahur me ndihma humanitare në ushqim dhe veshmbathje.

Partner: Komuna e Ferizajt

Mbështetja e përfshirjes sociale të fëmijëve nga Mahalla e Romëve, Mitrovicë



Në projektin: Forcimi i përfshirjes sociale të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë, rezultati kryesor i arritur deri më tani është se këta fëmijë dhe prindërit e tyre që jetojnë në Mahallën e Romëve, të cilët mbështeten përmes programit Portage, kanë përmirësuar kujdesin ndaj edukimit dhe sjelljes në funksion të zhvillimit të gjithmbarshëm të fëmijëve. Kjo vërehet praktikisht nëpërmjet zhvillimit pozitiv të zgjeruar fizik dhe kognitiv tek më shumë se 70% e gjithsejt 105 fëmijëve të përfshirë në program.

“Unë kam pranuar mbështetje nga edukatorët e Caritasit, ata ma kanë përfshirë në shkollë fëmiun tim me nevoja të veçanta” – Nafije Qazimi, Nënë.

Gjatë vitit 2022 projekti vazhdoi me qasjen e aplikuar në intervenimin e mëparshëm dhe zgjerimin në komuna tjera duke mbuluar edhe komunitetet tjera pakicë përveç banorëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Mahallës së Romëve.

Rezultat konkret ishte informimi i mbi 2000 familjeve të tjera për rëndësinë e imunizimit në kohë dhe rrjedhimisht 500 fëmijë u imunizuan si rezultat i fushatës së imunizimit.

“Ishte bukur në punëtori sepse folëm për fëmijët, shkollën, sa të rëndësishme janë vaksinat dhe shpesh bënim gjëra të ndryshme për shtëpinë.” – Isnije Gushani, nëna e fëmijës, pjesëmarrëse në punëtorinë me prindërit dhe fëmijët.



Ndërkohë, është bërë përparim i dukshëm edhe me shkollimin fillor, sot shkollimin fillor e ndjekin 250 fëmijë, të shpërndarë në 14 klasa, 2 paralele për çdo klasë të ulët (1-5) dhe 1 paralele për klasat e larta (6-8). Në klasën parashkollore këtë vit janë regjistruar 36 fëmijë. Të gjithë fëmijët kanë transport të organizuar nga Mahalla e Romëve deri në shkollën që ndodhet në Mitrovicën e Veriut

“Falë Caritasit, jeta e fëmijës tim është më e lehtë tani” – Saranda Dumoni, nënë, përfituese e mbështetjes sociale dhe shëndetësore.

Ekipi i projektit organizoi më shumë se 20 takime avokuese me përfaqësues të akterëve të ndryshëm institucional, gjë që mundësoi zgjidhjen e më shumë se 30 çështjeve dhe nevojave praktike me administratën lokale të rëndësishme për jetën e përditshme të fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Partner: UNICEF Kosovë



Fusha strategjike:

Ndihma në situatat e fatkeqësive
natyrore dhe të konflikteve



Forcimi i qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar gjatë Covid-19



Caritas Kosova ka luajtur rol të rëndësishëm në orfimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për kategoritë e cënueshme, sidomos për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar, edhe gjatë periudhës së pandemisë.

Në vitin 2022, nëpërmjet metodologjisë së vetë-përkrahjes/self help, ne jemi përpjekur të rrisim përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të moshuarve dhe Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) në aktivitete të ndryshme sociale. 78 të moshuar (33 meshkuj dhe 45 femra) dhe PAK janë përfshirë rregullisht në grupet e vetë-përkrahjes (GVP) në aktivitete të përgjithshme të degëve lokale të Caritas Kosova dhe Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar në 9 komuna. Në secilin grup ka rreth 8 anëtarë të cilët janë takuar një herë në javë. Shumica dërrmuese e tyre janë persona të moshuar (46 nga 78 janë persona të moshuar), ndërsa të tjerët janë PAK.





Gjatë këtyre takimeve stafi i projektit u fokusua kryesisht në tema të tilla si: ushqimi i shëndetshëm; aktivitetet e përditshme; aktivitete sociale dhe iniciativa të reja; dhimbje psiko-somatike; interesat personale; sasia dhe cilësia e gjumit; mbështetja sociale; cilësia e jetës.

Përveç lehtësimit psikologjik që këta persona gjetën në GVP, ata kanë rritur edhe interesin dhe angazhimin në aktivitete të ndryshme shoqërore si udhëtimi së bashku, takimi me miq të rinj, ecja, ushtrimet, vullnetarizmi, etj.

Prandaj, ky aktivitet i ndihmoi ata të kuptojnë se ata nuk duhet të jenë vetëm pranues pasiv të përkrahjes, por që të aktivizohen sa më shumë. Këto GVP janë krijuar në komunat: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Viti, Prizren, Kaçanik, Hanin e Elezit dhe Kamenicë.

Është hartuar hulumtimi me personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët informalë për çështjet që lidhen me epideminë Covid-19, por edhe për problemet ekzistuese por të cilat u përkeqësuan nga pandemia. Janë dhënë rekomandimet/modele të politikave për hartuesit e politikave për të përmirësuar shërbimet e kujdesit afatgjatë si dhe në valën e dytë të mundshme të Covid-19, dhe emergjencave të tjera (valët e të nxehtit, përmytjet, thatësit, tërmetet, kushtet e vështira të dimrit, etj.).



Gjatë këtij viti, në kordinim me shoqata të ndryshme, institucione relevante dhe OJQ, janë shpërndarë dhe shkëmbyer informacione në lidhje me shërbimet dhe aktivitetet e zbatuara.

Caritas Kosova ka shpërndarë 1000 pako me artikuj ushqimorë dhe jo ushqimorë për përfituesit në 5 regjione: Prishtinë, Prizën, Mitrovicë, Viti dhe Ferizaj.



Partnerët: Bashkimi Evropian, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Red Cross-Serbi

CONEX



Në përgjithësi, situata e pandemisë me Covid-19 në Kosovë u shoqërua me nivele të shtuara të frikës dhe ankthit në nivel individual dhe shoqëror. Kjo erdhi si pasojë e informacioneve të pamjaftueshme për virusin, kërkesave strikte për respektimin e masave mbrojtëse dhe kufizimit të lëvizjes, si dhe dyshimi për efikasitetin e sistemit shëndetësor.

Situata pandemike ka prekur grupet më të marginalizuara, kryesisht të moshuarit, gratë e papuna dhe personat me aftësi të kufizuara. Këto kategori përveç problemeve shëndetësore po përballen edhe me vështirësi ekonomike. Në këtë drejtim, projekti Conex është fokusuar në trajtimin e nevojave bazë që janë: mungesa e ushqimit, medikamenteve dhe furnizimeve të tjera thelbësore, përkeqësimi i kushteve ekonomike, si dhe izolimi dhe mungesa e aksesit në shërbimet sociale. Duke pasur parasysh këtë, objektivi i përgjithshëm i projektit Conex është: “Të kontribuojë dhe të lehtësojë pasojat humanitare dhe socio-ekonomike të krizës së shkaktuar nga Covid-19, duke i kushtuar vëmendje të veçantë personave të moshuar, grave dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit si kategoria më e marginalizuar në vend”.

Caritas Kosova në partneritet me Shoqatën Nënë Tereza, po sigurojnë zbatimin cilësor të aktiviteteve të projektit në Prishtinë, Prizren dhe Gjakovë.



Në vitin 2022, aktivitetet e Projektit Conex u përqëndruan kryesisht në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe mbështetje në zhvillimin ekonomik.

Dy ekipe të Home Care kanë ofruar shërbime sociale dhe shëndetësore përmes vizitave në shtëpi.

Në total, 4 infermiere të 2 ekipeve të Home Care, kanë shërbyer më shumë se 235 përfitues, ku në 3592 vizita kanë ofruar 15532 shërbime.

Po në këtë vit, CK ka shpërndarë 538 pako familjare me artikuj ushqimorë dhe jo ushqimorë.

Në fokus më të madh gjatë këtij viti ishin aktivitet e zhvillimit ekonomik ku gjithsej përfituan 161 persona në trajnime profesionale si: parukeri dhe estetikë, kuzhinë dhe pastiqeri, praktikë në punë dhe grante.

Këtë vit, në komunën e Prizrenit dhe të Gjakovës, u certifikuan 30 gra për parukeri dhe estetikë, dhe 30 gra të tjera në kuzhinë dhe pastiqeri. Një bashkëpunim shumë i hapur dhe korrekt ishte me Qendrën për Aftësim Profesional dhe Zyrën për Punësim në Komunën e Prizrenit.

Projekti Conex vazhdoi përkrahjen e mëtutjeshme për zhvillimin e kapaciteteve të 18 grave në punë praktike në sektorin e biznesit, ku 10 prej tyre përfunduan me punësim të rregullt dhe 5 gra me vetëpunësim.



Bashkpunimi me sektorin e shoqërisë civile është një komponent tjetër i rëndësishëm, ku u trajnuan 18 përfaqësues të 10 organizatave joqeveritare në fushën e avokimit, se si avokimi mund të përdoret si mjet për ndikim në vendimmarrje. Ky bashkëpunim do thellohet edhe me tutje me konkretizimin dhe elaborimin e sfidave, takimeve me OJQ, dhe me vendim-marrës të pushtetit lokal.

Në fund të vitit 2022, Caritas Kosova zhvilloi kriteret për grante që kanë për qëllim fuqizimin dhe pavarësimin ekonomik të grave. Kjo thirrje u publikua në muajin dhjetor duke ofruar kushte të barabarta për të gjitha përfitueset e projektit. Pesë grante planifikohen të shpërndahen dhe materializohen në fillim të vitit 2023.


Në fund të vitit 2022, Caritas Kosova zhvilloi kriteret për grante që kanë për qëllim fuqizimin dhe pavarësimin ekonomik të grave. Kjo thirrje u publikua në muajin dhjetor duke ofruar kushte të barabarta për të gjitha përfitueset e projektit. Pesë grante planifikohen të shpërndahen dhe materializohen në fillim të vitit 2023.

Buxheti Vjetor

Buxheti Vjetor 2020	4 413 969 €
----------------------------	--------------------


Home Care/Përkujdesi Shtëpiak & Mbështetja e Shërbimeve Ambulatore	3 012 479 €
Bamirësia dhe Solidariteti	5 200 €
SOCIETIES	19 849 €
Ndalo dhe Ndihmo	29 955 €
Kuzhina Popullore	31 250 €
Pakot humanitare, Masa 3.4	100 000 €
ACTIVE	31 760 €
Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës	22 948 €
YourJob	80 547 €
PRAXIS	115 503 €
Kopshti "Engjujt"	504 763 €
My Right - Qendra e Edukimit të Hershëm	34 000 €
Përfshirja sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	247 548 €
Forcimi i qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar gjatë Covid-19	66 394 €
CONEX	82 688 €
ODSS	12 983 €
Tjera	16 102 €

Përqindja sipas projekteve



- Home Care/Përkujdesi Shtëpiak & Mbështetja e Shërbimeve Ambulatore
- Bamirësia dhe Solidariteti
- SOCIETIES
- Ndalo dhe Ndihmo
- Kuzhina Popullore
- Pakot humanitare, Masa 3.4
- ACTIVE
- Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës
- YourJob
- PRAXIS
- Kopshti "Engjujt"
- My Right - Qendra e Edukimit të Hershëm
- Përfshirja sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian
- Forcimi i qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar gjatë Covid-19
- CONEX
- ODSS
- Tjera

Përqindja sipas Donatorëve



Rrjeti Caritas

Institucionet Qendrore dhe Lokale

Institucionet dhe Organizatat ndërkombëtare

Bashkimi Evropian

Tjera